

KONTRATË BINJAKËZIMI

Përkrahje për Statistikat

Kosovë



RAPORT MBI MISIIONIN

Një sistem Cilësie për Statistikat

Organizimi i punës rreth cilësisë në statistika

Komponenti 1

Misioni i realizuar nga Lars Thygesen

26-29 Gusht 2014

IPA 2012

Emri, adresa, emaili i autorit

*Lars Thygesen
Statistics Denmark
Sejrøgade 11
DK-2100 Copenhagen Ø
Denmark
Tel: +4539173941
Email: lth@dst.dk*

Përmbajtja

Lista e shkurtesave	3
1. Komete të përgjithshme.....	4
2. Vlerësimi dhe rezultatet	4
3. Konkluzione dhe rekomandime	5
3.1 Politika e cilësisë	5
3.2 Mandati grupit për cilësi	5
3.3 Anketa mbi zbrazëtitë/mangësitë tek stafi në ASK.....	5
3.4 Anketa mbi kënaqshmërinë e përdoruesve.....	5
3.5 Programi për takimin me përdoruesit	5
3.6 Lista kontrolluese	6
3.7 Termat e referencës për aktivitetin e ardhshëm.....	6
Aneksi 1. Termat e Referencës.....	7
Aneksi 2. Personat e takuar.....	10
Aneksi 3. Drafti i programit për takimin me përdoruesit	11
Aneksi 4. Lista kontrolluese	12

Lista e shkurtesave

CoP	Kodi i Praktikës
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
QAF	Korniza e Sigurimit të Cilësisë (Eurostat)
TeR	Termat e Referencës
SIDA	Agjencia Suedeze për Zhvillim Nderkombëtar

1. Komente të përgjithshme

Ky raport i misionit është përgatitur në kuadër të Projektit të Binjakëzimit 'Përkrahje për Statistikat'. Është misioni i pestë në komponentin 1 të projektit. Misioni kishte për qëllim të monitorojë se çfarë është arritur nga misioni i fundit dhe të definojë aktivitetet e ardhshme në kuadër të këtij komponenti.

Objektivat konkrete të misionit ishin:

Vazhdimi i procesit të diskutimit dhe rekomandimeve lidhur me organizimin e punës rreth cilësisë në ASK. Gjithashtu, diskutimi i veprimeve të ndërmarra nga ASK që nga misioni i kaluar.

Diskutimi dhe paraqitja e shembujve nga vendet anëtare: Organizimi, rolet, politika, përfshirja e përdoruesve, anketa e kënaqshmërisë së përdoruesve.

Konsulentët dëshirojnë të falënderojnë të gjithë zyrtarët dhe personat e takuar, për mbështetjen dhe informacionet e vlefshme që kanë dhënë, gjë që ka lehtësuar shumë punën e konsulentëve dhe e kanë bërë qëndrimin në Kosovë të këndshëm dhe të paharrueshëm.

Këndvështrimet dhe vëzhgimet e paraqitura në këtë raport janë ato të konsulentëve dhe jo domosdoshmërisht përputhen me këndvështrimet e BE-së, ASK-së apo Statistikave të Danimarkës.

.

2. Vlerësimi dhe rezultatet

Gjatë këtij misioni u mbajt takimi me anëtarët e grupit për cilësi duke mbuluar çështjet në vijim:

1. Organizimi i punës së cilësisë. Grupi për cilësi tashmë është formuar dhe funksionon
2. Diskutimi dhe finalizimi i drafteve për mandatin e grupit për cilësi
3. Diskutimi dhe finalizimi i draftit të deklaratës së cilësisë
4. Diskutimi i anketës lidhur me nevojat për trajnime
5. Diskutimi i anketës mbi kënaqshmërinë e përdoruesve
6. Organizimi i takimit me përdoruesit. Kush për çfarë do të jetë përgjegjës dhe afatet kohore përkatëse
7. Diskutim: Menaxhimi i qasjes tek të dhënat mikro

Rakomandimet lidhur me këto aktivitete paraqiten në kapitullin e ardhshëm.

Gjatë misionit gjithashtu u mbajt një takim me Kryeshefin Ekzekutiv dhe me zyren e BE-së. U vendos që këshilltari rezident i projektit të përgatisë ndryshimin e nevojshëm të kontratës për të ndarë aktivitetet me SIDA-n dhe për të emëruar udhëheqësin e ri të projektit nga ana e vendeve anëtare.

U diskutua edhe koha për misionin e ardhshëm. Parashihet që kjo të jetë java 20-24 Tetor, eksprët Lars Thygesen dhe Hilka Vihavainen. Gjatë këtij misioni do të mbahet edhe takimi me përdoruesit.

3. Konkluzione dhe rekomandime

3.1 Politika/përkushtimi i cilësisë

U diskutua dhe u plotësua politika dhe deklarata e cilësisë, e hartuar nga ASK-ja. Të gjithë ranë dakord që deklarata është e gatshme për t'iu prezantuar Kryeshefit. Duhet të miratohet dhe publikohet sa më shpejt që është e mundur, planifikuar deri më 1 tetor, dhe më pas të implementohet.

3.2 Mandati grupit për cilësi

U diskutua drafti i mandatit të grupit për cilësi, u përshtat dhe dakordua nga grupi. Tani I njëjti duhet të finalizohet nga grupi (në rast se ka nevojë për ndonjë ndryshim shtesë). Më pas duhet ti prezantohet Kryeshefit Ekzekutiv, të miratohet dhe të publikohet në ASK para misionit të ardhshëm në tetor. Menjëherë pas kësaj duhet të fillojë implementimi.
Personi përgjegjës: Ramizi

3.3 Anketa lidhur me zbrazëtitë/mangësitë tek stafi i ASK-së (Competence gap)

ASK-ja prezantoi një draft të kësaj ankete, që tashmë është implementuar në një division dhe është konsideruar e lehtë dhe e dobishme.

Afatet kohore:

- 1 muaj për miratim ose korrigjim, gjatë diskutimeve në departamente, të cilat do t'i raportojnë Ramizit, deri më 27 Shtator.
 - Miratimi i anketës nga Kryshefi dhe grupi për cilësi, 27 Shtator
 - 1 muaj për departamentet ta plotësojnë këtë anketë me stafin e tyre dhe t'i dorëzojnë rezultatet te Ramizi, deri më 27 Tetor.
 - Pastaj ato të diskutohen në Bord dhe të vendoset për veprimet e mëtejme.
- Personi përgjegjës: Ibrahim

3.4 Anketa mbi kënaqshmërinë e përdoruesve

Eksperti siguroi shembuj të ndryshëm nga dy shtete, Slovenia dhe Danimarka.

Në bazë të kësaj, ASK-ja do të hartojë pyetësin për takimit me përdoruesit dhe do t'ua dërgojë pjesëmarrësve. Në takim, do të kërkohet nga përdoruesit që ta plotësojnë këtë pyetësor, nëse nuk e kanë bërë këtë ndërkohë.

Rekomandohet të përdoret një program i thjeshtë (Excel ose ngjashëm), që të mos ketë nevojë për ndihmë nga TI.

Përgjegjës: Ibrahim

3.5 Programi për takimin me përdoruesit

U diskutua dhe dakordua lidhur me draftin e programit dhe planit për përgatitjen e takimit me përdoruesit. Drafti i programit paraqitet në aneksin 3. Përgjegjësi është e Ramizit.

Lista e mëposhtme “Kush çfarë do të bëjë” është dakorduar por duhet të plotësohet më tej nga ASK-ja, pas përfundimit të misionit:

- Koordinimi dhe menaxhim (Ramizi)
- Dhoma (p.sh. do të mbahet në dhomën e takimeve në ASK)
- Emrat e pjesëmarrësve, me shkronja të mëdha dhe të lexueshme (Nora)

- Materiali (raporti mbi gjendjen aktuale, prodhimi, publikimet, material për projektin e binjakëzimit)
- Anketa mbi kënaqshmërinë e përdoruesve (Ibrahimi)
- Identifikimi i pjesëmarrësve (lista e pjesëmarrësve)
- Ftesa pjesëmarrësve, kur?
- Prezantimet
- Të pranishëm: Kryeshefi, drejtorët në ASK
- Finalizimi nga grupi për cilësi
- Paraqitja tek Kryeshefi dhe miratimi
- Publikimi i brendshëm para misionit të ardhshëm në tetor
- Implementimi

3.6 Lista kontrolluese

U diskutua dhe u plotësua drafti nga misioni i kaluar. Tani konsiderohet përfundimtare. Shih aneksin 4.

Hapi i ardhshëm është miratimi nga Kryeshefi. Pastaj, duhet të implementohet sipas një plani.

3.7 Termat e references për aktivitetin e ardhshëm

Termat e referencës duhet të përgatiten dhe të dërgohen mjaft kohë përpara misionit. Duhet të përfshijnë takimin me përdoruesit.

Aneksi 1. Termat e Referencës

**Projekti i Binjakëzimit i BE-se
KS12 IB ST 01
Përkrahje për Statistikat**

cs

Termat e Referencës:**Komponenti 1: Një Sistem Cilësie për Statistikat****Aktiviteti 1.2.1: Organizimi i punës rreth cilësisë në Statistika****Afatet kohore:**

TeR –të gatshëm: 12 Gusht 2014

Fillimi /përfundimi i aktivitetit: 26-28 Gusht 2014

Raportimi: 12 Shtator 2014

Rezultatet obligative të komponentit:

Mandatory Result 1.2.1	Organizimi i punës rreth cilësisë në statistika	Raportet mbi misionet, që ofrojnë këshilla operationale për sigurimin e cilësisë në fushën prodhimit statistikor, të nxjerra në faqen e projektit	- Raportet tremujore të projektit të binjakëzimit - Raportet mbi misionet - Udhëzuesit	- disponeshmeria në të gjitha nivelet e stafit të ASK-së dhe menaxhmentit - Komunikimi dhe pjesëmarrja efektive e të gjitha subjekteve relevante - Stafi punon në realizimin e detyrave, që lidhen me projektin, në mes misionëve - Resurse të mjaftueshme (njerëzore dhe materiale)
-------------------------------	---	---	--	---

Tema / qëllimi i aktivitetit 1.2.1

Ky aktivitet do të vazhdojë procesin e diskutimeve dhe rekomandimeve lidhur me atë se si mund të organozohet më së miri puna rreth cilësisë në ASK. Do të diskutohen edhe veprimet e ndërmarra që nga misioni i kaluar.

Me shembujt nga vendet anëtare, do të diskutohen dhe dakordohen me ASK-në organizimi, rolet, politika e cilësisë, përfshirja e përdoruesve, anketa mbi kënaqshmërinë e përdoruesve.

Produkti i pritur nga aktiviteti 1.2.1:

Raporti mbi misionin, ku përshkruhet gjendja aktuale në lidhje me punën rreth cilësisë në ASK, harta rrugore, e detajuar, për aktivitetet e ardhshme në kuadër të 1.2.1. Marrëveshja me ASK-në se si të organozohet takimi me përdoruesit, i cili do të mbahet gjatë misionit të ardhshëm në tetor 2014.

Ekipi ne ASK:

Z. Ramiz Ulaj, Drejtor i Departamentit, ramiz.ulaj@rks-gov.net ASK (Udhëheqës i komponentit)

Ibrahim Rustemi, Drejtor i Departamentit të Administratës; ibrahim.rustemi@rks-gov.net

Hazbije Qeriqi, Përgjegjëse për Komunikim dhe Informim; hazbije.qeriqi@rks-gov.net

Arta Salihu, Zyrtare e Lartë për Koordinim; arta.salihu.morina@rks-gov.net

Burim Limolli Shef i TI-së; burim.limolli@rks-gov.net

Bekim Canolli, Shef i Divizionit të Metodologjisë; bekim.canolli@rks-gov.net

Drita Sylejmani, Zyrtare e Lartë për Diseminim, drita.sylejmani@rks-gov.net

Ekspertët e vendëve anëtare:

Mr Lars Thygesen, Drejtor, Shitje dhe Marketing, Statistikat e Danimarkës, lth@dst.dk

Ekipi i Projektit të Binjakëzimit:

Z Per Knudsen, RTA, pkn@dst.dk

Znj Nora Zogaj, asistente e RTA, nzogaj@yahoo.com

Historiku

Gjatë 4 misionëve në projektin e binjakëzimit tashmë është shënuar progres në fushën e cilësisë. Është formuar grupi për cilësi dhe është emëruar menaxheri i cilësisë. Në qershor, ekspertët nga ASK-ja morën pjesë në Konferencën Evropiane mbi cilësinë në statistikat zyrtare, që u mbajt në Vjenë.

Në prill të vitit 2014, projekti i binjakëzimit dhe projekti i SIDA bashkë me ASK-në bënë një vlerësim të nevojave dhe mundësive për vendosjen e një sistemi të metadatave (Grosen). Konkluzionet nga ky aktivitet ishin që ASK nuk është akoma e gatshme për një sistem të avansuar të integruar të metadatave. Fokusi kryesor duhet të jetë në përshkrimet e statistikave sipas kërkesave të Eurostat-it.

Gjatë këtij aktiviteti të përbashkët mes binjakëzimit dhe SIDA, u rekomandua që ASK të përdorë SIMS (Single Integrated Metadata Structure) si strukturë për konceptin e cilësisë. Përshkrimet aktuale të përfunduara në formatin ESMS duhet të transferohen në formatin SIMS.

Aktivitetet, që duhet të ndëmirren si parapërgatitje për misionin:

- Raporti i misionit 1.0.1: Faza I: Zhvillimi i hartës rrugore për implementimin e sistemit të menaxhimit të cilësisë (Vihavainen & Thygesen)
- Raporti mbi misionin 1.0.2 Faza I: Vazhdim i zhvillimit të hartës rrugore për implementimin e sistemit të menaxhimit të cilësisë (Vihavainen & Thygesen)

- Raporti i misionit: 1.3.1: Prezantimi I raporteve të cilësisë sipas standardeve të Eurostat-it (Grosen)

Aktivitetet e pritura janë

- Diskutimi se si të organizohet puna rreth cilësisë në një institut statistikor
- Zhvillimi i planit të detajuar të punës
- Marrëveshja me ASK-në për afatet kohore
- Marrëveshja me ASK-në se kush çfarë do të bëjë lidhur me organizimin e takimit me përdoruesit në tetor 2014
- Diskutime se si të menaxhohet qasja tek të dhënat mikro

Rezultatet e pritura:

- Raporti mbi misionin – sipas modelit për raportim
- Plani i detajuar për aktivitetet e ardhshme në lidhje me Cilësinë

Aneksi 1. Programi - Gusht 2014

Dita	Vendi	Koha	Ngjarja
1	ASK	10:00	Planifikimi i dy ditëve
		10:30	ASK: Vështrim mbi progresin e arritur që nga misioni i fundit në Cilësi
		10:45	Pushim për kafe
		11:00	Organizimi i punës rreth cilësisë, shembuj nga vendet anëtare
		12:00	Dreka
		13:15	Organizimi i punës rreth cilësisë, shembuj nga vendet anëtare
		14:30	Pushim për kafe
		15:00	Diskutim dhe planifikimi i ditës së dytë
2	KAS	09:00-15:30	Organizimi i punës rreth cilësisë, shembuj nga vendet anëtare Menaxhimi i qasjes tek të dhënat mikro Takimi me përdoruesit. Planifikimi. Drafti i programit. Kush çfarë do të bëjë dhe kur?
3	ASK/Zyra e BE-së	09:00-16:00	Takim me Zyren e BE-së në Kosovë Planifikimi i misionit të ardhshëm Raporti
4	ASK	09:00-15:00	Dakordimi lidhur me rekomandimet dhe afatet kohore Takim me Kryeshefin Ekzekutiv të ASK-së Takim me udhëheqësin e projektit në ASK: Rekomandimet, afatet kohore dhe programi i punës përkatës për ASK Raporti

Aneksi 2. Personat e takuar

1. Burbuqe Kelmendi, Koordinatore për Binjakëzim, Zyra e BE-së në Kosovë
2. Isa Krasniqi, Kryeshef Ekzekutiv në ASK
3. Ramiz Ulaj, Drejtor i Departamentit, (Udhëheqës i komponentit, Kryesues i Grupit për Cilesi)
4. Ibrahim Rustemi, Drejtor i Departamentit të Administratës; (anëtar i Grupit për Cilesi)
5. Servete Muriqi, Zyrtare e Lartë në Metodologji (Menaxhere e Cilësisë në Grupin për Cilësi)
6. Xhevdie Fetahu, Shefe e Divizionit të Llogarive Kombëtare (anëtare e Grupit për Cilësi)
7. Ismail Sahiti, Shef i Divizionit të Statistikave Ekonomike (anëtar i Grupit për Cilësi)
8. Avni Zejnullahu, Divizioni i Anketave (anëtar i Grupit për Cilësi)
9. Emina Deliu, Departamenti i Statistikave Sociale,
10. Bekim Canolli, menaxher i cilësisë
11. Drita Sylejmani, Zyrtare e Lartë për Diseminim

Ekipi i projektit:

Per Knudsen, RTA

Nora Zogaj, asistent i RTA

Agim Aliu, përkthyes

Aneksi 3. Draft i programit për takimin me përdoruesit

1. Mirëseardhje dhe hyrje (Krasniqi) (5 minuta)
2. Objektivi: Çfarë duam të dimë (Krasniqi) (5 minuta)
3. Cilësia statistikore (Lars) (15 minuta)
4. Politika e cilësisë e ASK-së – çfarë kemi bërë, deklaratat e cilësisë (Ramizi) (15 minuta)
5. Databaza statistikore (Burimi) (10 minuta)

Pushim për kafe

6. Planet për të ardhmen (10 minuta)
7. Pyetje për përdoruesit: (Krasniqi, Hilka) (30 minuta)
8. Për çfarë i përdorni statistikat? Cilat statistika i përdorni?
9. Çfarë mungon?
10. A janë deklaratat e cilësisë etj. të dobishme?
11. Plotësimi i anketës mbi kënaqshmërinë e përdoruesve (që iu dërgohet edhe paraprakisht)
12. Konkluzione (10 minuta)

Dreka

Aneksi 4. Lista kontrolluese

Num-ri	Procesi	Po	Jo	Evidenca
Përgatitja dhe mbledhja e të dhënave/regjistrimi				
1	A është azhurnuar korniza e mostrës?			
2	A është kontrolluar dizajni i mostrës?			
3	A është rishikuar pyetësi (dhe azhurnuar, nëse është e nevojshme)?			
4	A janë trajnuar intervistuesit për këtë anketë?			
5	A janë testuar aftësitë e intervistuesve për të plotësuar pyetësin?			
6	A janë vlerësuar aftësitë e trajnuesve për të trajnuar intervistuesit?			
7	A është monitoruar në terren saktësia e plotësimit të pyetësorve dhe a është raportuar në ASK lidhur me këtë?			
8	A është kontrolluar nga Departamenti i TI-së softveri i futjes së të dhënave?			
9	A janë trajnuar auditorët dhe stafi që bën validimin dhe redaktimin në ASK?			
10	A është trajnuar stafi për futjen e të dhënave në ASK për këtë anketë?			
Përpunimi i të dhënave në divizionin statistikor				
11	A është kontrolluar futja e të dhënave mikro dhe a janë korrigjuar gabimet?			
12	A krahasohen rezultatet e prodhuara nga anketa nga ana e sistemit të TI-së me rezultatet e fituara gjatë procesit të mbledhjes së të dhënave?			
12a	A janë krahasuar rezultatet e anketës me shifrat nga anketa/statistika të tjera të ASK-së ose të institucioneve të tjera (nëse ekzistojnë shifra të tillat)?			
13	A krahasohen rezultatet e anketës me rezultatet e mëhershme të anketës?			
Publikimi / diseminimi				
14	A janë përgatitur publikimet, raportet etj.?			
15	A janë në përputhje publikimet me procedurat e raportimit të ASK (p.sh. kriteret e shkrimit teknik)?			
16	A është bërë publikimi i rezultateve në afatin e paracaktuar?			